




KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0014451-10/26 dt. 27.03.2026
Mitrovicë



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 17, pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040, Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/15, qershor 2008); nenin 20, të Ligjit Nr. 04/L-032 Për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 17/2011, publikuar më dt. 16.09.2011); nenit 5, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-068 Për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 30/2002, publikuar më dt.15.06.2008); nenit 14 paragrafi 8, nënparagrafi 8.1, të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.19/2024 Për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të Drejtorëve, Zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar; si dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 27.03.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese

- Me këtë vendim FORMOHET Komisioni për zgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese Parauniversitare, në përbërje:
 - 1.1 Valon Hetemi - Kryetar i Komisionit (DKA),
 - 1.2 Sinan Tupella - Anëtar i Komisionit (DKA Drejtor shkolle), dhe
 - 1.3 _____ përfaqësues i MASH-it.
- Komisioni përzgjedhës i formuar me pikën 1 të këtij vendimi do të kryej detyrat e përcaktuara sipas ligjeve dhe akteve ligjore në fuqi.
- Mandati i anëtarëve është i përkohshëm ad hoc dhe vlen vetëm për konkurset për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese si në vijim: IP "Dritë Dielli" Shipol, SHFMU "Bedri Gjinaj" Mitrovicë, SHFMU "Xhevat Isufi" Bare, SHFMU "Avni Shabani" Zabërgjë, SHFMU "Aziz Sylejmani" Mitrovicë, SHFMU "Bislim Imeri" Këçiq i Madh, SHFMU "Ismail Qemali" Mitrovicë, SHFMU "Musa Hoti" Mitrovicë, SHFMU "Gj. K. Skënderbeu" Mitrovicë, SHFMU "Shaban Idrizi" Mitrovicë, SHMLA "Tefta Tashko" Mitrovicë, SHFMU "Trepça" Stan Tërg, SHFMU "Jashar Begu" Vllahi, SHFMU "Elmaz Peci" Rahovë, SHFMU "Abdullah Shabani" Mitrovicë, SHMLA "Hasan Prishtina" Mitrovicë, SHMLT "Arkitekt Sinani", Mitrovicë, SHFMU "Abdullah Shabani Mitrovicë (Zv.Drejtor), SHMLM "Dr. Xheladin Deda" (Zv.Drejtor) Gjinnazi "Frang Bardhi" (Zv.Drejtor).
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Arsimit
- Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
DKA-së
Anëtarëve të Komisionit